

Vendim nr. 166 datë 17.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 17.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (J) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **JAK PËRPALAJ**, përfaqësuar nga avokat Xhemal Gazidede, me prokurë.

OBJEKTI: **Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.**
Konstatimi i cenimit të parimeve themelore të gjykimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në lidhje me bazueshmërinë ligjore për vendimin nr. 00-2023-4667, datë 02.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 132, pika 1 dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Jak Përpalaj ka qenë i punësuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT). Ai ka mbajtur detyrën “Inspektor i dytë” në sektorin e verifikimit në terren pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT), Tiranë, duke pasur statusin e nëpunësit civil nga viti 2010.

2. Me vendimin nr. 919, datë 28.02.2013 të drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve, kërkuesi është liruar nga detyra (*vendimi i lirimit nga detyra*). Ky vendim është bazuar edhe në urdhrin e Kryeministrit nr. 130, datë 06.11.2012 “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të punonjësve të administratës tatimore qendrore” dhe urdhrin e ministrit të Financave nr. 7, datë 13.12.2012 “Për miratimin e organigramës të punonjësve të administratës tatimore qendrore”.

3. Në datën 14.06.2013 kërkuesi ka paraqitur padi kundër DPT-së dhe DRT-së, Tiranë, në të cilën ka kërkuar konstatimin si absolutisht të pavlefshëm dhe shfuqizimin e vendimit të lirimit nga detyra, rikthimin në vendin e mëparshëm të punës ose ofrimin e një vendi pune të të njëjtit nivel në administratën publike, qendrore ose vendore, si dhe pagesën e një viti punë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 560, datë 22.01.2014, ka shpallur moskompetencën lëndore dhe ia ka dërguar aktet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

4. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2038, datë 02.05.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë së kërkuesit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2642, datë 15.09.2016, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë administrative. Gjykata e apelit i ka gjetur të drejta përfundimet e kësaj të fundit në lidhje me marrëdhënien juridike të shërbimit civil mes palëve dhe rregullimin e saj nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” (*ligji nr. 8549/1999*), i cili parashikonte të drejtën e ankimit të nëpunësit civil pranë Komisionit të Shërbimit Civil, të drejtë të cilën paditësi nuk e ka ushtruar, çka për pasojë ka sjellë shqyrtimin nga gjykata vetëm të atyre pretendimeve të tij që kishin të bënin me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ të kundërshtuar dhe zgjidhjen e pasojave të një pavlefshmërie të tillë. Në vijim, gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë edhe përfundimin e gjykatës administrative të shkallës së parë për mosvërtetimin e ndonjë prej rasteve të pavlefshmërisë absolute të vendimit të lirimit nga detyra të paditësit, sipas nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative dhe referuar ligjit nr.

8549/1999, pasi ai vendim është nxjerrë nga një organ i identifikueshëm, brenda kompetencave të tij dhe në përputhje me ligjin nr. 8549/1999. Së fundi, gjykata e apelit ka vërejtur se shkaqet e ngritura në ankim kanë të bëjnë me pavlefshmërinë relative të aktit të kundërshtuar dhe jo me pavlefshmërinë absolute të tij, ndaj ato nuk janë të tilla që të determinojnë ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2023-4467, datë 02.11.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

7. Në datën 20.05.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr.8577/2000, është regjistruar më 03.06.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material e procedural, në rrethanat kur gjykatat më të ulëta nuk kanë hetuar çështjen në bazë të ligjit nr. 8549/1999, ndërsa vendimi për lirimin nga detyra të kërkuesit është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, sepse është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën ligjore, duke rënë ndesh me kërkesat e këtij ligji dhe të VKM-së nr. 360, datë 14.07.2000, në lidhje me lirimin nga shërbimi civil për shkak ristrukturimi.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik,

subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

10. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në përfundim të të cilit është marrë vendimi i kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Kërkuesi plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, pasi objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë ai nuk ka mjet tjetër ligjor për të shteruar për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara përveç kërkesës në këtë Gjykatë.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo datë kur vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 02.11.2023, kurse ankimi kushtetues individual është depozituar në shërbimin postar në datën 20.05.2024, pra pas më shumë se 6 muajsh. Nga komunikimi elektronik i datës 07.06.2024, Gjykata e Lartë ka konfirmuar se vendimi objekt kundërshtimi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 29.12.2023, datë në të cilën ai është bërë i disponueshëm për palët. Gjithashtu, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për

efekt të këtij shqyrtimi, rezulton se sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Lartë, në datën 29.12.2023 ka bërë njoftimin elektronik të vendimit të saj për kërkuesin në adresën elektronike të lënë nga përfaqësuesi i zgjedhur prej tij, i cili është i njëjti me atë që ka paraqitur edhe ankimin kushtetues. Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, kërkuesi ose përfaqësuesi i tij ligjor edhe pse ka barrën e provës në këtë drejtim, në ankimin e tij nuk ka parashtruar ndonjë fakt ose argument për marrjen dijeni efektivisht për vendimin e Gjykatës së Lartë në një datë të ndryshme nga ajo e njoftimit elektronik të përfaqësuesit të tij.

14. Për sa më lart, nën dritën e rrethanave të rastit konkret dhe duke pasur parasysh standardet e vendosura në lidhje me momentin e marrjes dijeni të vendimit të organit gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, Kolegji konstaton se vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Lartë i është njoftuar elektronikisht përfaqësuesit të kërkuesit në datën 29.12.2023, e cila përbën edhe datën e fillimit të afatit ligjor të ankimit kushtetues individual, ndërkohë që kërkesa është paraqitur në datën 20.05.2024, pra disa javë përtej afatit ligjor 4-mujor. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk përmbush kriterin e legjitimitimit *ratione temporis*.

15. Në kushtet kur një nga kriteret paraprake nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë për shqyrtim të kërkesës bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.